



Australian Government



Si të bisedoni me fëmijët në lidhje me vaksinat kundër COVID-19

E përditësuar së fundi herë: 8 Gusht 2022

Vaksinimi gjithashtu është i rëndësishëm për disa fëmijë të moshës 6 muajshe deri 4 vjeç që janë me imunokompromitet të rënduar apo kanë invaliditete, si dhe ata që kanë gjendje shëndetësore komplekse dhe/apo të shumëfishtë që rrisin rrezikun nga COVID-19 i rëndë. Është e natyrshme për fëmijën tuaj të jetë kurioz dhe të ketë shumë pyetje në lidhje me vaksinimet kundër COVID-19. Këtu i keni disa këshilla që mund t'ju ndihmojnë që të flisni me fëmijët para dhe pasi të marrin vaksinën.

Me rëndësi është të qëndroni të përditësuar me këshillat më të reja mjekësore të disponueshme në [uebfaqen e Departamentit e Shëndetësisë dhe Kujdes për të Moshuarit \(Department of Health and Aged Care\)](#).

Gjithashtu mund të diskutoni ndonjë shqetësim apo pyetje që keni në lidhje me vaksinimin kundër COVID-19 me ofruesin tuaj të imunizimit apo mjekun para se fëmija juaj të merr vaksinën.

Me rëndësi është të dëgjoni përgjigjet e tyre dhe të informoheni për ndonjë frikë që ata kanë nga vaksinimi.

- Më tregoni se çfarë dini deri më tani në lidhje me vaksinat kundër COVID-19.
- A keni marrur ndonjë vaksinë më parë?

Mundësitë janë që fëmija juaj të ketë marrur vaksinë më parë dhe se nuk ka qenë diçka e keqe.

Sqaroni singerisht dhe në mënyrë të duhur sipas moshës se çfarë dini në lidhje me vaksinat kundër COVID-19.

Mbani mend se fëmijët marrin sinjale emocionale nga të rriturit, ashtu që ndarja e frikës mund të mos jetë konstruktive dhe të bën që fëmija të mos ndjehet rehatshëm.

Sqaroni se mjeku apo profesionisti mjekësor do t'i bën fëmijës tuaj disa pyetje, se fëmija do të merr një gjilëpë në krahë (apo këmbë nëse ata kanë 6 muaj deri në më pak se 5 vjeç) dhe se do të ndjejnë një shpuarje të vogël dhe se gjilpëra mund të jetë pak e dhimbshme më vonë.

Siguroni fëmijën tuaj duke i thënë se është normale të jetë pak e dhimbshme aty ku gjilpëra do të hyn, dhe se kjo do të thotë se bari është duke funksionuar.

Nëse fëmija juaj duket i shqetësuar në lidhje me vaksinimin, provoni t'i eksploroni ndjenjat e tyre më tutje apo kërkoni më shumë këshilla nga mjeku juaj nëse është e nevojshme

Përgjigjuni pyetjeve të fëmijës tuaj

Bëni gati disa përgjigje për fëmijën për disa pyetje që mund t'i ketë fëmiju. Këtu i keni disa pyetje dhe përgjigje kryesore që mund t'ju ndihmojnë në këtë bisedë:

Përdorni shembuj të vërtetë, siç është mbrojtja e gjyshërve të fëmijës apo për të qenë të aftë të bëjnë gjëra siç është të shkoni shkollë dhe në ekipet sportive nëse mendoni se kjo do të ndihmon.

Në Australi, ata janë testuar mirë nga një agjenci që siguron se të gjitha barnat janë të sigurta. Ato nuk do t'ju jepeshin njerëzve nëse nuk do të ishin të sigurta.

Nëse fëmija juaj frikësohet nga gjilpërat, përgatitja efektive dhe teknikat e shpërqendrimit janë të rëndësishme.

Për fëmijët të moshës 5 vjeç e lartë mund të jetë e dobishme të ndjekin lokacion më të vogël të nojur, siç është një barnatore lokale apo një ambulancë e përgjithshme. Vendet e mëdha për vaksinim mund të jenë të zhurmshme dhe të zëna, e kjo rrit shqetësimin.

Sjellni me vete lodrat apo librat më të preferuara të fëmijës suaj për të krijuar përvojë pozitive dhe shpërqendrim.

Njoftoni ofruesin tuaj prej më parë nëse fëmija juaj frikësohet nga gjilpërat ashtu që ata të mund të ndajnë kohë të mjaftueshme dhe të sigurojnë që procesi nuk është përshpejtuar apo detyruar.

Mund të vizitoni **uebfaqen e Departamentit të Shëndetësisë dhe për Kujdes të të Moshuarve (Department of Health and Aged Care)** në www.health.gov.au për më shumë informacione në lidhje me vaksinimin.

Gjithashtu mund të thirrni Linjën nacionale për ndihmë për koronavirus (National Coronavirus Helpline) në **1800 020 080**. Shtypni opcionin 8 për shërbime përkthimi.

Nëse jeni të shurdhër apo keni probleme në të dëgjuarit dhe të folurit, mund të thirrni Shërbimin Rele (National Relay Service) në **133 677**.